

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR  
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA  
FUSHATA ZGJEDHORE PER KUVENDIN E SHQIPERISE 2013  
PERIUDHA 23.06.2013

---

**RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA  
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA NGA PARTIA  
“BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT”**

Tirane më, 15 Shtator 2013

## Tabela e përmbajtjes

### **RAPORTI I VEÇANTË I AUDITIT TË PAVARUR PASQYRA E TË ARDHURAVE (Financimet dhe Donacionet) PASQYRA E SHPENZIMEVE (Përdorimi i fondeve sipas destinacionit) INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

#### **Referencat ligjore:**

Për kryerjen e këtij misioni jemi mbështetur në përputhje me:

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.
- Ligjin nr.10019.datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr.10091.datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"
- Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë.

PORT I AUDITORES TE PAVARUR  
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE SHPENZUARA  
FUSHATA ZGJEDHORE PER KUVENDIN E SHQIPERISE 2013  
PERIUDHA 23.06.2013

---

***Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve***

Une kam audituar pasqyrën (deklaratën) bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë për zgjedhjet parlamentare të kuvendit të Shqipërisë për periudhën 23.06.2013.

***Pasqyra eshte pergjegjesi e drejtimit te subjektit zgjedhor*** Partia BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT .

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga Partia BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT bazuar në librin e llogarive të Partisë dhe të rregjistrit të posaçëm, miratuar si model me vendimin e KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjitha transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore , që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtim – pagesave.

***Përgjegjësia ime*** është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tim.

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në referencë të veçantë me SNA 800 “Konsiderata të vecanta – auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qellime specifike’. Këto standarte kërkojnë që unë të veproj në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikoj e të kryej auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të kuvendit të Shqipërisë të mos përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale, qofte si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve , audituesi merr në konsideratë kontrollin e brëndshëm të Partisë në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sigurtë të pasqyrave financiare , me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të nevojshme

për rrethanat financiare, por jo me qëlimin që të shprehë një opinionin për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të partisë.

Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare, vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi i Partisë si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që unë kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë opinionin tim të auditimit.

Detyra e subjektit zgjedhor Partia BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT është të përgatisë pasqyrën bashkëlidhur mbi bazën e arkëtimit dhe pagesave.

Për mendimin tim, me përjashtim të efekteve që mund të lindin nga mosparaqitja e ndonjë dokumenti, pasqyra e bashkëlidhur e fondeve të përfituar dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT e datës 23.06.2013, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën arkëtimit dhe pagesave konform me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar 'Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare'.

Silvana Gjikhima

Eksperte Kontabile e Rregjistruar

Tiranë , më 15.09.2013

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR**

Subjekti zgjedhor Partia BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT e ka fituar zotësinë juridike për të vepruar, me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me urdher nr 6/1 date 24.02.1992.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë politike" neni 9, 10, 11 e të tjerë.

Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie gjejnë pasqyrim të qartë në Programin dhe Statutin e saj.

Subjekti zgjedhor Partia BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT është një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Qendra e Partisë BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT është në Tiranë.

### **Objekti i veprimtarisë :**

Partia BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT perpiqet dhe synon ndertimin dhe konsolidimin e shtetit te se drejtes, barazine per te gjithë shtetasit, pa dallime etnike ,fetare ,gjuhesore ,racore ,dhe krahinore.

Ajo mbron te drejtat dhe lirite e te gjithë shtetasve dhe ne vecanti te drejtat e pakicave kombetare, me te cilat mban maredhenie te ngushta dhe bashkerendon veprimtarine me shoqatat dhe organizatat qe perfaqesojne keto pakica.

Gjithashtu ne statut jane percaktuar te drejtat dhe detyrat e anetareve te partise.

Drejtimi I Partise behet nga Kryesia e Partise

Administrimi I saj behet nga Kryetari I Partise

### **Burimet e financimit janë :**

- Buxheti i Shtetit financiar për fushatë 760.732 leke. ( I pa terhequr )

-Kuotat e antaresise jane ( 0 ) lekë.

- Nga fondet e partise te financuara nga buxheti I shtetit 6,866,348 leke .

Burimet financiare jan përdorur drejtpërsëdrejti për të realizuar qëllimet dhe objektivat e subjektit zgjedhor.

## **1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL**

### **a. Mënyra e Prëgatitjes së Pasqyrave Financiare.**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar, të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,“ të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhën vendase në Lekë .

### **a. Rregullat për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.**

#### **Të Ardhurat.**

**Të ardhurat** janë të pasqyruara mbi bazën e arkëtimeve të burimeve të financimit të vëna në dispozicion të Partisë BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT. Te ardhurat perbehen nga fondet e partise te financuara nga buxheti I shtetit per vitin 2012 ne masen 6,866,348 leke . Fondi I financuar nga buxheti per fushaten ne masen 760,732 leke nuk eshte terhequr.

**Detyrimet, ose Shpenzimet** janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave tatimore, mandat arktimëve dhe mandat pagesave dhe dokumentave orgjinale kontabël.

Shpenzimet sipas analizes jane te pasqyruara te pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve ne Shumen 6,886,348 leke.

Të gjitha shpenzimet janë bërë nga arka dhe jo nëpërmjet llogarisë bankare, megjithëse shumat e paguara janë më të vogla se kufiri i vënë nga organet fiskale dhe që nuk përbën shkelje. Do të ishte mirë që në të ardhmen veprimet të kryhen nëpërmjet llogarisë bankare.

Tiranë më, 15 shtator 2013

## PARTIA "BASHKIMI I TE DREJTAVE TE NJERIUT"

## PASQYRA E ARKËTIMEVE PAGESAVE TË BËRA PËR FUSHATËN ZGJEDHORE 23.06.2013

Përshkrimi	Lekë
<b>A- Të Ardhurat</b>	
Fondi financiar nga buxheti për fushatën zgjedhore	760,732 ( IPA TERHEQUR )
Nga fondet e Partise	6,86,348
Fonde të dhuruara nga persona fizik për fushatë	
<b>Fonde të përftuara nga keshilltaret</b>	
<b>Totali të ardhurave, burimeve, (arkëtimeve)</b>	<b>6,886,348</b>
<b>B- SHPENZIME PËR FUSHATËN(deri më 23.06.2013)</b>	<b>0</b>
1- Botim gazetash	466,900
2- Karburant,	963,170
3- Pregatitje dhe montim banerash	1,299,778
4-Hapje dhe mbyllje fushate	1,031,400
5-transport materialesh dhe personash	442,330
6-postera ,fletepalosje,kartvizita	912,800
7-Qera sallash ,darka koktej	735,590
8- Paisje zyresh elektorale ne rrethe	224,000
9-Reklame e TV lokale	35,000
10-Shperblime per kontribut ne fushate	353,000
11- Te tjera	422380
<b>Shpenzime gjithsej</b>	<b>6,886,348</b>
<b>Mbetje</b>	<b>0</b>

KRYETARI I PBDNJ  
VANGJEL DULE





